

VENDIM
Nr. 86, datë 6.2.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 321, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË
PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES
POLICORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, të pikave 1, shkronja “a”, dhe 3, të nenit 70, të ligjit nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, dhe të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 e vendimit nr. 321, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e elementit “paga për funksion”, në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave për funksionet organike me numra rendorë 1, 2 dhe 3 dhe rezultat i indeksimit në masën 2.5% për funksionet e tjera organike.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2026, përballohen nga buxheti i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, të miratuara në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1**Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**

Nr.	Funksioni organik	Paga për funksion	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
1	Ndihmësspecialist (vëzhgues/mbikëqyrës) në trupën operacionale	70,500	15,000
2	Ndihmësspecialist (përpunues informacioni) në kartotekë	70,500	10,000
3	Specialist në drejtoritë rajonale	88,000	15,000
4	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme	93,275	12,000
5	Specialist për vlerësimin kalimtar dhe periodik (VETING-un)	93,275	20,000
6	Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale	97,375	17,000
7	Përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme	112,750	15,000
8	Përgjegjës sektori për vlerësimin kalimtar dhe periodik (VETING-un)	112,750	20,000
9	Titullar i drejtorisë rajonale	112,750	20,000
10	Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme	133,250	17,000
11	Këshilltar i drejtorit të përgjithshëm	133,250	0
12	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	153,750	22,000
13	Drejtor i përgjithshëm	174,250	30,000